MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË HEKURUDHAVE, DURRËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhave, Durrës me objekt "Mbi kontrollin e veprimtarisë ekonomiko-financiare, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë" për periudhën nga 30.06.2009-31.10.2011, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 34 datë 13.03.2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 323/8 datë 13.03.2012, dërguar Z. Zamir Ramadani, Drejtor i Përgjithshëm i Hekurudhave, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave SHA në vijim të funksionimit dhe detyrimit për përshtatje, të evidentojë ndërhyrjet e nevojshme në statutin datë 18.12.2000, me qëllim përafrimin e dispozitave të statutit me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të përshtasë organizimin dhe funksionimin e saj në përputhje me dispozitat statutore, si dhe të miratojë këto ndryshime në Asamblenë e Aksionarëve, e cila përfaqësohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Menjëherë

2. Të rishikohet rregullorja e funksionimit të shoqërisë, duke përcaktuar kompetencat dhe përgjegjësitë për çdo post pune, sipas organikës së miratuar.

Menjëherë

3. Të revokohen urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 952, datë 25.10.2010 dhe nr. 331, datë 18.04.2011, për caktimin e pagës së punonjësve të komanduar në detyrën e Drejtorit të Njësisë së Biznesit të Mallrave dhe Drejtorit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, sipas tabelës së pagave dhe Kodin e Punës së RSH, duke kryer pagesën ndaj drejtuesve të mësipërm, e llogaritur si diferencë ndërmjet pagës së vendit të ri të punës dhe pagës që marrin aktualisht nga DPH.

Menjëherë

4. Të përmirësohet niveli i përfaqësimit të shoqërisë në mbrojtje të interesave të shoqërisë në marrëdhënie me të tretët në rrugë administrative dhe gjyqësore.

Menjëherë

5. Programimi i tregueseve ekonomiko-financiar të bëhet në përputhje me gjendjen reale të shoqërisë, për të bërë të mundur që programi të jetë sa më afër reales, si në drejtim të të ardhurave dhe shpenzimeve ashtu dhe në përcaktimin saktë të subvencionit.

Vazhdimisht

6. Drejtoria të shqyrtoj dhe të analizojë shkaqet, dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për vonesat në përpunimin e vagonëve të huaj, pasi detyrimi i DPH-së ndaj atyre homologe, për periudhën 2009-2010 është 443,152 euro.

Vazhdimisht

7. Drejtoria e shoqërisë të shikojë mundësinë e uljes së më tejshme të numrit të punonjësve, për të arritur një nivel të pranueshëm të shpenzimeve, i cili pasqyrohet në kostot operative.

Vazhdimisht

8. Ndihma shtetërore për kompensimin e kostove të ofrimit të shërbimeve publike në veçanti, për mbulimin e shpenzimeve operative të shërbimit të transportit të udhëtarëve, të alokohet në funksion të realizimit të tregueseve të programuar mbështetur në kriteret e vendosura nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.

Vazhdimisht

9. Drejtoria e DPH-së të jetë më reaguese ndaj kërkesave të tregut, për të futur shërbime të përmirësuara midis Tiranës dhe Durrësit, të bëjë studime mbi konservimin e linjave jo rentabile (Fier dhe Vlorë), të përmirësojë sistemet e kontrollit të sinjalizimit për të përmirësuar sigurinë, të bëjë zëvendësimin e parkut të vagonëve, dhe të kombinojë reformat në subjekt me ndërhyrjen e shtetit në drejtimet më imediate.

Vazhdimisht

10. DPH të hartojë një data baze ku të përditësohen të dhënat e operatorëve ekonomik, të cilët ofrojnë mallra, punime e shërbime specifike për hekurudhën. Të kryejë blerje nga operatorë ekonomik të cilët kanë objekt të veprimtarisë objektin e prokurimit, të ngrejë struktura të specializuara për studimin e tregut dhe marketingun.

Vazhdimisht

11. DPH-ja të bëjë planifikimin e natyrës, sasisë dhe llojit të kontratave që do të prokurohen me procedurën e blerjeve me vlera të vogla dhe të përfshihet në raportimin periodik (çdo 4/mujor) të realizimit të prokurimeve publike edhe procedurat e prokurimit të realizuara për blerjet me vlera të vogla.

Vazhdimisht

12. DPH -ja të përgatisë një dokument ku të përshkruaj organizmin dhe procedurat kontabël, i cili është i nevojshëm për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së kontrollit.

Menjëherë

13. Organet drejtuese të shoqërisë (Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria), të analizojnë shpenzimet për gjoba dhe penalitete, të cilat për vitet 2009- 2010 janë në vlerën 4 milionë lekë, duke përcaktuar personat përgjegjës, të cilat janë ngarkuar në bazë të ligjit apo akteve nënligjore e rregullative.

Menjëherë

14. Të merren masa konkrete për evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të debitorëve, duke koordinuar punën me strukturat përkatëse për përmirësimin e dokumentacionit për arkëtimin e debitorëve, gjendja e të cilëve në fund të viteve 2009 e 2010, është respektivisht në vlerat 144 milionë lekë dhe 152 milionë lekë.

Vazhdimisht

15. Të derdhen në Buxhetin e Shtetit detyrimet për "sigurimet shoqërore e shëndetësore", për vitet 2009 dhe 2010, gjendja e të cilave paraqitet në fund të viteve, respektivisht në vlerat 11 milionë lekë dhe 12 milionë lekë, për detyrimin "tatim mbi të ardhurat personale", gjendja në fund të viteve 2009, 2010 është respektivisht në vlerat 2 milionë lekë dhe 3 milionë lekë dhe detyrimi për "tatimin në burim" për vitin 2010 është në vlerën 18 milionë lekë.

Vazhdimisht

16. Të shqyrtohet nga organet drejtuese të shoqërisë (Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria), trendi në rritje i detyrimeve ndaj "furnitorëve", pasi konstatohet një punë e pamjaftueshme e strukturave të saj për ndjekjen e tyre në rrugë ligjore. Gjendja e tyre në fund të viteve, 2009 e 2010 është përkatësisht në vlerat 148 milionë lekë dhe 121 milionë lekë, ndërsa ajo e "debitorëve e kreditorëve të tjerë" në vitet 2009 dhe 2010 rezultojnë përkatësisht në shumën 27 milionë lekë dhe 37 milionë lekë.

Vazhdimisht

17. Drejtoria e Shoqërisë të shqyrtojë dhe analizojë shkaqet dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për gjendjen e lartë të inventarëve në fund të viteve 2009 dhe 2010, përkatësisht në vlerat 354 milionë lekë dhe 274 milionë lekë, pasi kjo gjendje nuk justifikohet me objektin e shoqërisë dhe se ajo rrezikohet me krijimin e stokut me qarkullim të ngadalshëm.

Vazhdimisht

18. Dhënia e ambienteve me qira për sipërfaqet mbi 200 m2 dhe mbi 500 m2 në administrim nga DPH-ja, të bëhet me konkurrim nga organi i varësisë administrative MPPTT dhe METE me të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore.

Vazhdimisht

19. Të emërohet drejtori në strukturën e auditimit të brendshëm, me qëllim që të kontrollohet plotësisht aktiviteti ekonomik, financiar e teknik i DPH -së.

Menjëherë

20. Ti likuidohet Buxhetit të Shtetit detyrimi në vlerën 21milionë lekë, i cili përfaqëson detyrimin në masën 70% të arkëtimeve për objektet e dhëna me qira deri me 11.08.2011, konform Kapitullit VI, të VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 "Për dhënien me qira ose Enfiteozë të Pasurive të Ndërmarrjeve, Shoqërive dhe Institucioneve Shtetërore".

Menjëherë

B. MASA ZHDËMTIMI

1. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **1,139,192 lekë,** që përbën vlerën e sigurimit të ofertës të dy operatorëve ekonomik të tërhequr nga gara në mënyrë të njëanshme, pas hapjes së ofertave më datë 29.08.2011 [redacted] përkatësisht në vlerën 569,596 lekë), nga kompania e sigurimeve [redacted]

2. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **358,704** lekë, që përbën dëm ekonomik për penalitet të aplikuar në kundërshtim me nenin 5 pika 5.1 e kontratës dhe nenit 2 pika 2.2, nenit 24 pika 24.1 germa "a" kushtet e përgjithshme të kontratës të miratuar në DST për mosrealizimin e kontratës nr. 9, datë 20.10.2009 me objekt "Blerje traversave hekurudhore dhe aksesorë", nga operatori ekonomik "[redacted].

3. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **49,510 lekë**, që përbën dëm ekonomik për mos aplikim të penaliteteve konform kushteve të kontratave të qirasë, nga operatorët ekonomik [redacted] dhe"[redacted].

C. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në tenderat e zhvilluar për periudhën 30.06.2009-31.10.2011 dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar për çdo tender, mbështetur në nenin 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe pikës 3**,** kreut X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, i kërkojmë APP-së **<u>të vlerësojë shkeljet e konstatuara</u>**, duke rekomanduar marrjen e masave administrative e disiplinore për punonjësit si më poshtë:

1. z. [redacted] në cilësinë kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave;

2. z. [redacted], në cilësinë e anëtarit së komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi:

- Kanë kualifikuar ofertuesit/kandidat, në kundërshtim me nenin 53, pika 3 LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT "kërkesat e pranim/kualifikimit";
- Nuk kanë skualifikuar ofertuesit/kandidat, kur kanë ekzistuar rrethanat e parashikuara në nenin 45, të LPP-së, pika 2/d.

Këto shkelje janë konstatuar në tenderin me objekt: "Blerje traversa betoni", me vlerë limit të kontratës 36,667 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 09.10.2009.

3. [redacted] në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi: ofertuesit/kandidat në kundërshtim me nenin 53, pika 3 LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT "kërkesat e pranim/kualifikimit";

- Nuk ka skualifikuar ofertuesit/kandidat, kur kanë ekzistuar rrethanat e parashikuara në nenin 45, të LPP-së, pika 2/d.

Këto shkelje janë konstatuar në tenderat me objekt:

- "Blerje traversa betoni", me vlerë limit të kontratës 36,667 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 09.10.2009.

-“Punime mbishtrese hekurudhore nga vetë hekurudha për “Riaktivizimi i Stacionit të Kasharit (furnizim dhe vendosje ndërruese hekurudhore , me vlerë limit të kontratës 19,707,648 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 19.07.2011.

-“Ruajtja me SHRSF e stacioneve hekurudhore, për zonën e jugut”, me vlerë limit të kontratës 6,569 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 04.04.2011

- “Ruajtja me SHRSF e stacioneve hekurudhore, për zonën e veriut”, me vlerë të përllogaritur të kontratës 5,109 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 11.04.2011;

-“Ruajtja me SHRSF e stacioneve hekurudhore, për zonën Tiranës”, me vlerë të përllogaritur të kontratës 3,284 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 30.05.2011;

- “Ruajtja me SHRSF e stacioneve hekurudhore, për zonën e veriut”, me vlerë të përllogaritur të kontratës 11,678 mijë lekë TVSh, zhvilluar më datë 31.05.2011.

4. [redacted] në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, dhe

5. [redacted] në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi:

- Kanë kualifikuar operatorët ekonomik “Infra Trans Projekt” dhe “SPIT”, në kundërshtim me nenin 53, pika 3 LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranim/kualifikimit”;

Kjo shkelje është konstatuar në tenderin me objekt: “Hartimi i plotë i projektit të zbatimit për riaktivizimin e stacionit të Kasharit”, me vlerë limit të kontratës 5,000 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 04.04.2011.

6. [redacted] në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi:

- Ka kualifikuar operatorët ekonomik “Infra Trans Projekt” dhe “SPIT”, në kundërshtim me nenin 53, pika 3 e LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranim/kualifikimit”;

Këto shkelje janë konstatuar në tenderat me objekt:

- “Hartimi i plotë i projektit të zbatimit për riaktivizimin e stacionit të Kasharit”, me vlerë limit të kontratës 5,000 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 04.04.2011;

-“Punime mbishtrese hekurudhore nga vetë hekurudha për “Riaktivizimi i Stacionit të Kasharit (furnizim dhe vendosje ndërruese hekurudhore , me vlerë limit të kontratës 19,707,648 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 19.07.2011.

7. [redacted] në cilësinë kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi:

- Ka kualifikuar operatorët ekonomik “ABCD” dhe “Fort” në kundërshtim me nenin 53, pika 3 e LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranim/kualifikimit” .

Kjo shkelje është konstatuar në tenderin me objekt: “Punime mbishtrese hekurudhore nga vetë hekurudha për “Riaktivizimi i Stacionit të Kasharit (furnizim dhe vendosje ndërruese hekurudhore, me vlerë limit të kontratës 19, 707,648 lekë pa TVSh), zhvilluar më 19.07.2011.

8. [redacted] në cilësinë e kryetarit dhe anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi:

- Nuk ka skualifikuar ofertuesit/kandidat, kur kanë ekzistuar rrethanat e parashikuara në nenin 45, të LPP-së, pika 2 /d.

Kjo shkelje është konstatuar në tenderat me objekt:

- “Hartimi i plotë i projektit të zbatimit për riaktivizimin e stacionit të Kasharit”, me vlerë limit të kontratës 5,000 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 04.04.2011;

-“Ruajtja me SHRSF e stacioneve hekurudhore, për zonën e jugut”, me vlerë limit të kontratës 6,569 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 04.04.2011;

- “Ruajtja me SHRSF e stacioneve hekurudhore, për zonën e veriut”, me vlerë të përllogaritur të kontratës 5,109 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 11.04.2011;

-“Ruajtja me SHRSF e stacioneve hekurudhore, për zonën e Tiranës”, me vlerë të përllogaritur të kontratës 3,284 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 30.05.2011;

- “Ruajtja me SHRSF e stacioneve hekurudhore, për zonën e veriut”, me vlerë të përllogaritur të kontratës 11,678 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 31.05.2011.

9. [redacted] në cilësinë e anëtarit së komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi:

- Nuk ka skualifikuar ofertuesit/kandidat, kur kanë ekzistuar rrethanat e parashikuara në nenin 45, të LPP-së.

Këto shkelje janë konstatuar në tenderat me objekt:

-“Ruajtja me SHRSF e stacioneve hekurudhore, për zonën e jugut”, me vlerë limit të kontratës 6,569 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 04.04.2011;

-“Ruajtja me SHRSF e stacioneve hekurudhore, për zonën Tiranës”, me vlerë të përllogaritur të kontratës 3,284 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 30.05.2011;

- “Ruajtja me SHRSF e stacioneve hekurudhore, për zonën e veriut”, me vlerë të përllogaritur të kontratës 11,678 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 31.05.2011.

10. [redacted] në cilësinë e anëtarit së komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi:

- Ka kualifikuar operatorët ekonomik “Alba” dhe “Miri”, në kundërshtim me nenin 53, pika 3 LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranim/kualifikimit”

- Nuk ka skualifikuar ofertuesit/kandidat, kur kanë ekzistuar rrethanat e parashikuara në nenin 45, të LPP-së.

Këto shkelje janë konstatuar në tenderat me objekt:

“Hartimi i plotë i projektit të zbatimit për riaktivizimin e stacionit të Kasharit”, me vlerë limit të kontratës 5,000 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 04.04.2011.

- “Ruajtja me SHRSF e stacioneve hekurudhore, për zonën e veriut”, me vlerë të përllogaritur të kontratës 5,109 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 11.04.2011.

D. MASA DISIPLINORE

a) Këshilli Mbikëqyrës të analizojë Raportin Përfundimtar të Kontrollit dhe mbështetur në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” neni 167 pika 2, Statutin e DPH-së neni 9, për shkeljet e cilësuara në këtë raport, **<u>të shkarkojë anëtarët e Drejtorisë së Shoqërisë:</u>**

1. [redacted]**,** në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm;

2. [redacted] në cilësinë e Zv/Drejtores së Përgjithshme;

3. [redacted] në cilësinë e Drejtor i Njësisë së Shërbimeve Mbështetëse;

4. z[redacted] në cilësinë e Drejtorit të Njësisë së Biznesit të Mallit;

5. [redacted] në cilësinë e Drejtorit të Shërbimeve të Mjeteve Lëvizëse;

6. [redacted] në cilësinë e Drejtorit të Biznesit të Udhëtarit;

7. [redacted] në cilësinë e Drejtorit të Njësisë së Biznesit dhe Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore,

8. [redacted] në cilësinë e Drejtorit të Njësisë Ekonomike.

b) Duke analizuar të gjitha parregullsitë dhe shkeljet financiare të konstatuara dhe evidentuara gjatë kontrollit të ushtruar në DPH, mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995, "Kodi i Punës", i ndryshuar dhe në nenin 52, kreu IX "Masa Disiplinore" të Kontratës Kolektive të Punës, të datës 24.11.2009, kërkojmë që ndaj personave përgjegjës të merren masat disiplinore si më poshtë:

"Vërejtje me shkrim", për:

1. [redacted] në cilësinë e kryetarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla;

2. [redacted] në cilësinë e anëtares të blerjeve me vlera të vogla;

3. [redacted]**,** në cilësinë e anëtarit të blerjeve me vlera të vogla, dhe

4. [redacted] në cilësinë e anëtares së blerjeve me vlera të vogla, pasi:

- Nuk kanë bërë planifikimin e natyrës, sasisë dhe llojit të kontratave që do të prokurohen me procedurën e blerjeve me vlera të vogla;
- Nuk kanë hartuar regjistrin e realizimit të prokurimeve, të blerjeve të realizuara me këtë procedurë;
- Nuk kanë përfshirë në raportimin periodik të realizimit të prokurimeve publike, edhe procedurat e prokurimit të realizuara për blerjet me vlera të vogla;

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 2/a të Kreut VI "Zhvillimi i procedurës ..., prokurim me vlerë të vogël ...", të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", pikën 2 dhe 4 të Udhëzimit nr. 2, datë 18.02.2008 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla".

c) Për drejtuesit dhe punonjësit

1. [redacted] ish Drejtori i Njësisë së Biznesit dhe Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore;

2. [redacted] ish Drejtor i Njësisë së Biznesit të Udhëtarëve;

3. [redacted] ish Drejtor i Njësisë së Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse, që përmenden në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, sipas përgjegjësive përkatëse është tejkaluar masa disiplinore, e përcaktuar në nenin 37, ligji nr. 7961, datë. 12.07.1995 "Kodi i Punës" i ndryshuar si dhe në nenin 52, kapitullin IX "Masa Disiplinore", të kontratës kolektive të punës, të lidhur më datës 09.11.2009, pasi këta punonjës janë shkarkuar nga këto funksione nga strukturat drejtuese të DPH-së, **prandaj masa që do të propozonte grupi i kontrollit quhet e ezauruar.**

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Shefki Jaupi**,** Andi Buzo**,** Klejdi Xhani, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT